

## Pozicion Vakant

**Balkan Finance Investment Group**, BALFIN Group, është një nga grupet investuese më të rëndësishme dhe më të suksesshme në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Gjeografikisht, Grupi BALFIN është i pranishëm në Austri, Shqipëri, Kosovë, Bosnjë dhe Hercegovinë, Maqedoni Veriore, Mali i Zi dhe Holandë, me afërsisht 6'000 punonjës në total. Aktivitetet e Grupit BALFIN përfshijnë zhvillimin dhe menaxhimin e pasurive të patundshme, shitjet me pakicë, industrinë minerare, sistemin bankar, turizmin, energjinë, logjistikën, etj. Grupi BALFIN po rritet në mënyrë të qëndrueshme dhe kontribuon në përmirësimin e jetesës së komuniteteve përmes zhvillimit ekonomik, prezantimit të ideve të reja, punësimit dhe investimeve sociale. Kompania Green Coast pjesë e Grupit Balfin është një kompani e fokusuar në projektimin, ndërtimin, vënien në shfrytëzim, administrimin, mirëmbajtjen, operimin e Resorteve Turistike, zhvillimit të Objekteve dhe Fshatrave Turistike dhe njësive të hotelerisë.

**Pozicioni:** Oficer Investimesh Green Coast

**Departamenti:** Administratë

**Vendndodhja:** Tiranë

**Përmbledhja e Pozicionit:** Oficeri i Investimeve është përgjegjës për ndjekjen, monitorimin, zhvillimin dhe përfundimin e projektit. Në funksion të këtij qëllimi, oficeri i investimeve duhet të përmbushë përgjegjësi dhe detyra menaxheriale, organizative, mbikëqyrëse dhe koordinuese. Përgatit propozime për vendimmarrje. Drejton procesin e dokumentimit që nga marrja e projekteve, fazat e oponencës, kontrollet mbi devijimet, dorëzimet e projekteve dhe marrjen e konfirmimeve për lejen e ndërtimit.

**Detyrat dhe Përgjegjësitë Kryesore:**

- Ndjek detyrimet kontraktuale të nënkontraktorëve/ projektuesve/ zhvilluesve/ investitorëve;
- Ndjek projektin që nga marrja në dorëzim nga studioja e projektimit / investitorët deri në dorëzimin e certifikatave të pronësisë dhe nënshkrimin e kontratave / marrëveshjeve me zhvilluesit;

- Koordinon punën midis studiove të projektimit të fushave të ndryshme (arkitekturë / infrastrukturë / projekte inxhinierike) dhe merr konfirmimin e Investitorit lidhur me to;
- Sigurohet që Projekt-ideja dhe zhvillimet strategjike të projektit kanë marrë konfirmimin e Investitorit;
- Sigurohet dhe kontrollon projektin e saktë dhe të konfirmuar para aplikimit për leje ndërtimi;
- Sigurohet dhe kontrollon që të mos ketë devijime nga projekti edhe pas marrjes së lejes së ndërtimit;
- Përgatitja dhe menaxhimi i buxhetit të projektit në të gjitha rastet e nevojshme;
- Ndjek planin e biznesit të projekteve dhe e përditëson atë sipas zhvillimeve të tyre;
- Negocion kontratat / marrëveshjet e projekteve për të arritur marrëveshje fitimprurëse me palë të treta/ zhvillues;
- Siguron që cilësia e punimeve është sipas standarteve të duhura, duke mbikëqyrur dhe kontrolluar ecurinë e tyre në përputhje me standartet e kompanisë dhe KTZ, duke bërë audite periodike;
- Përgatit raporte periodike në lidhje me ecurinë e projekteve;
- Punon me strukturat përkatëse për të përcaktuar dhe analizuar kostot e projektit;
- Përgatit grafikët e projekteve dhe i ndjek ato deri në realizim brenda afateve të përcaktuara;
- Ndërmarrja e kontrolleve periodike të kantierit për të monitoruar progresin në kantier;
- Siguron dokumentimin në të gjitha fazat e projektit dhe përgatit plane afatshkurtra në varësi të progresit të projektit;
- Bashkëvepron dhe koordinon me shoqëritë e grupit për asetet e përfituara nga projekti dhe që do t'i jepen atyre në zhvillim / shitje / menaxhim etj;
- Ndjek faturimet e projektuesve deri në likuidimin e tyre;
- Mban korrespondencë dhe dokumenton informacionin e shkruar;
- Detyra të tjera që i ngarkohen.

**Edukimi:** Të zotërojë diplomë universiteti në Arkitekturë

**Kualifikime të tjera:**

- Të ketë eksperiencë pune jo më pak se 5 vjet në këtë fushë;
- Aftësi shumë të mira menaxhuese, organizative, planifikuese, projektuese dhe komunikuese;
- Aftësi për të lexuar, analizuar dhe shpjeguar projektet, korrespondencat e biznesit, kontratat, procedurat dhe manuallet teknike;

- Aftësi për të menaxhuar projekte dhe kontrata të ndryshme specifike që përfshihen në projekte ndërtimi;
- Aftësi për të prezantuar në mënyrë sa më efektive problematikat, si dhe për të përpiluar raporte të ndryshme, etj;
- Njohuri shumë të mira të gjuhës angleze (njohja e një gjuhe tjetër të komunitetit evropian do të përbënte avantazh);
- Të ketë fleksibilitet lidhur me orarin e punës;
- Njohuri bazë në përdorimin e programeve kompjuterike (CAD, 3DMax; Photoshop, EXEL, MS-PROJECT (preferohet Revit, etc.)

#### Mënyra e aplikimit:

Të gjithë të interesuarit mund të aplikojnë duke dërguar CV-në e tyre dhe letrën e motivimit në adresën [hr@greencoast.al](mailto:hr@greencoast.al) me subjekt GC Investment Officer \_ 0921

*Afati i dorëzimit: 28/09/2021*

*\*Të gjitha aplikimet do të trajtohen me konfidencialitet të plotë sipas ligjit Nr. 9887 vendosur nga Kuvendi i Shqipërisë për "Mbrojtjen e të Dhënave Personale".*